



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 74, date 02.10.2018

PËR DHËNIEN E TITULLIT VENDOR TË NDERIT “QYTETAR NDERI”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 2.10.2018, me propozim të këshilltarit bashkiak z. Filip Guraziu, komisionit Drejtësi dhe Paqe, mbështetur në nenin 54 shkronja “m”, neni 55 pika 2, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 15 të ligjit nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr. 61, datë 30.11.2016 “Rregullore për titujt vendorë të nderit në Bashkinë Shkodër, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre“, relacionit datë 20.9.2018 të komisionit këshillimor për titujt vendorë të nderit në Bashkinë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Dhënien e titullit vendor të nderit “Qytetar Nderi” **Dr. Jörg Lüer**, me motivacionin:

Për kontributin dhënë përmes financimit të projekteve në dobi të nevojave shoqërore dhe ekonomike të familjeve shkodrane me përparësi atyre që ndodhen në gjakmarrje dhe ish të përndjekurve politikë, si dhe në promovimin e vlerave më të mira kulturore, historike, personale dhe natyrore të Shkodrës në komunitetin ndërkombëtar.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sekretari i këshillit bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 2.10.2018

Shpallur në datën 8.10.2018

Sekretar i këshillit

Suel Hadri

KRYETAR

Xhemal BUSHATI